



***RAPORT PARAPRAK I VLERËSIMIT TE NDIKIMIT  
NË MJEDIS***

**TEMA: «NDERTIM GODINE INDUSTRIALE, KAPANON»**

**ME VENDODHJE: FSHATIN VERBAS, BASHKIA PATOS, QARKU FIER**

**INVESTITOR: BESNIK DRIZA**

**SUBJEKTI «EURO ALB 2009» SH.P.K.**

**PERGATI : MSC. ING.MJEDISI DENISA KOLA**

**KORRIK 2016**

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Denisa Kola', is written over a faint circular stamp.



*Raporti i Vleresimit paraprak te Ndikimit në Mjedis*  
*“Ndertim godine industriale, kapanon”*

*Vendndodhje në Vain, Lezhe ne kordinatat GAUS KRUGE*  
*E =4383464.3*  
*N = 4508660.19*

- *Shtojca II pika 10. Prodhime infrastrukturore. b) Projekte per zhvillime urbane, duke perfshire dhe ndertimin e qendrave tregetare dhe parkimet per makina.*

**Hartoi Raportin: Msc. Ing.Mjedisi Denisa KOLA**

**Rishikoi Raportin: Ekspert Mjedisi Elgerti BIXHA**



**PERMBAJTJA**

<b>KREU I.....</b>	<b>5</b>
<b>HYRJE.....</b>	<b>5</b>
1.1 Legjislacioni Mjedisor ne Shqiperi.....	7
1.2 Metodika e pergatitjes se studimit te VNM.....	8
1.3 Infomacion mbi shoqerine.....	9
<b>KREU II.....</b>	<b>9</b>
<b>PERSHKRIMI I PROJEKTIT.....</b>	<b>9</b>
2.1 Qellimi i zhvillimit te projektit.....	9
2.2 Alternativa e analizuar.....	10
2.3 Vendodhja e projektit.....	10
2.4 Objektivat e projektit te propozuar.....	10
<b>KREU III.....</b>	<b>15</b>
<b>PERSHKRIMI I VENDIT DHE MJEDISIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI.....</b>	<b>15</b>
3.1 Karakteristikat e zones.....	15
3.2 Pershkrimi gjeologo-morfologjik i zones.....	15
3.3 Regjimi Klimaterik.....	16
3.4 Flora.....	19
3.5 Fauna.....	20
3.6 Hidrogeologjia.....	20
<b>KREU IV.....</b>	<b>21</b>
<b>PERSHKRIMI TEKNIK I PROJEKTIT.....</b>	<b>21</b>
4.1 Karakteristikat kryesore.....	21
4.2 Lenda djegese.....	22
4.3 Programi i punes.....	22
4.4 Furnizimi me uje.....	23
4.5 Furnizimi me energji elektrike.....	23
4.6 Faza e funksionimit.....	23
4.7 Mbetjet dhe emetimet ne mjedis.....	23
4.8 Zhurmat dhe vibracionet.....	23
<b>KREU V.....</b>	<b>24</b>
<b>VLERESIMI I NDIKIMEVE.....</b>	<b>24</b>
5.1 Ndikimet e mundshme ne shendetin e njerezve.....	25
5.2 Nivelet dhe ndikimet e zhurmave.....	25
5.3 Ndikimet ne rruge lokale dhe transport.....	25
5.4 Ndikimet ne flore dhe faune.....	26
5.5 Ndikimet ne toke.....	26
5.6 Ndikimet ne uje.....	26

5.7 Ndikimet ne ajer.....	26
5.8 Ndikimet ne klime.....	26
5.9 Ndikimet ne ekonomi.....	27
5.10 Ndikimet mbi trashegimine kulturore.....	27
5.11 Ndikimet me natyre nderkufitare.....	27
<b>KREU VI.....</b>	<b>27</b>
<b>MASAT PER ELEMENIMIN/ ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE.....</b>	<b>27</b>
6.1 Masat ndaj erozionit.....	27
6.2 Masat per emetimet ne ajer.....	28
6.3 Masat per uljen ne minimum te zhurmave.....	28
6.4 Masat per Shkarkimet ne uje.....	29
6.5 Masat per Depozitimet ne toke.....	29
6.6 Masat estetike dhe ekologjike.....	29
6.7 Masat rehabilituese, në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit.....	29
6.8 Masat ndaj zjarrit.....	30
<b>KREU VII.....</b>	<b>31</b>
<b>PLANI I MENAXHIMIT TE MBETJEVE.....</b>	<b>31</b>
<b>PLANI IMENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT .....</b>	<b>31</b>
7.1 Plani i menaxhimit .....	31
7.2 Plani i monitorimit te mjedisit .....	31
7.3 Auditimi mjedisor .....	36
<b>KREUVIII.....</b>	<b>36</b>
<b>KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>36</b>
8.1 Konkluzione .....	36
8.2 Rekomandime.....	37

## KAPITULLI I

### HYRJJE

Raporti synon te jape nje informacion te detajuar dhe te besueshem lidhur me ndikimin mjedisor te projektit te propozuar ne perdorimin e tokes, efektet lidhur me ndikimet ne floren, faunen, burimet e ujit, emetimin e gazeve sere ne atmosfere, shkarkimet ne toke, uje, ndotjen akustike, si dhe çdo ndikim social ekonomik ne punesimin lokal, permiresimin e infrastructures dhe ndikimeve te tjera te rendesishme mjedisore ose sociale, perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permisimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te çeshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit te aktivitetit mbi mjedisin human.
- Analizen e faktoreve pozitive e negative mjedisore, percaktimin e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vlersimin cilesor te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt.

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk eshte i rendesishem vetem per njerezit por eshte thelbesor dhe i nevojshem per te gjitha qeniet ne toke. Njerezit duhet te kuptojne se si perdorimi i burimeve mjedisore dhe perfitimet qe vijne nga ato te mos demtohen por te jete e mundur te perfitohet sot dhe ne te ardhmen. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere , perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Ndaj eshte e nevojshme qe shoqeria te ndergjegjesohet per ta mbajtur sa me paster mjedisin ku jetojme duke marre masat e duhura per trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve te demshem ne atmosfere qe gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme. Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne. Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithe perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithe. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta (te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore. Vitet e fundit industria e ndertimit ne vendin tone ka patur nje zhvillim te madh. Kompanite e ndertimit ne vendin tone jane nder subjektet e biznesit me me teper fitim dhe qe zhvillojne

nje aktivitet te madh ekonomik. Vet sektori i ndertimit ne vendin tone eshte nje nga shtyllat e ekonomise shqiptare dhe numeron nje numer te konsiderueshm te punesuarish, ne nje kohe qe kompanite e ndertimit sot jane nder taksa-paguesit me te medhenj te arkes se shtetit.

Aktiviteti te cilin ne do te trajtojme eshte "Ndertim godine industriale, Kapanon".

Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit te mjedisit natyror nga aktiviteti njerezor.

Kemi dy tipe te impaktit mjedisor:

- Shterimi i burimeve

- Ndotja

Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme.

### **SHPJEGIMI I AKRONIMEVE**

VNM- Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis

VKM- Vendim i Keshillit te Ministrave

MM- Ministria e Mjedisit

AKM- Agjensia Kombetare e Mjedisit

NJQV – Njesi e Qeverisjes Vendore

QKB- Qendra Kombetare e Biznesit

DRM- Drejtoria Rajonale e Mjedisit

### **Pasqyra e te dhënave kryesore**

**Projekti:** Ndertim godine industriale, kapanon

**Me vendndodhje:** Ne Fshatin Verbas, Bashkia Patos, Qarku Fier

**Kompania zhvilluese:** "EURO ALB 2009" shpk

**Pergatiti raportin e VNM-se:** "GBA" Studio sh.p.k

## 1.1 Legjislacioni Mjedisor ne Shqiperi

Ne Shqiperi fillesat e legjislacionit mjedisor shfaqen ne vitin 1993 , vit ne te cilin u hartua plani i pare i veprimit ne fushen mjedisore, qe perben dokumentin e pare zyrtar shqiptar mbi politikat mjedisore ne vend. Ky plan veprimi kombetar parashikonte se qeveria duhet te krijojte kuadrin ligjor , ekonomik dhe institucional per zgjidhjen e ceshtjeve mjedisore. Periudhen nga ky vit deri ne miratimin e Kushtetutes ne vitin 1998 mund ta konsiderojme si etapen e pare te zhvillimit te se drejtes shqiptare te mjedisit. Mbas vitit 1998 e ne vijim eshte periudha e dyte e zhvillimit te se drejtes shqiptare te mjedisit, e cila ka si tipar kryesor prirjen e perafimit me legjislacionin e Bashkimit European per mjedisin. Kuadri ligjor mjedisor shqiptar eshte ne persosje dhe pasurim te vazhdueshem dhe zhvillimi i tij nuk i eshte len rastesis, por ka si model dhe drejtues legjislacionin european te mjedisit. Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe demtimin e komponenteve te vecante dhe te rendesishem te mjedisit nga faktore te ndryshem, njerezore dhe natyrore. Nder ligjet me kryesore ne lidhje me kete projekt, mund te permendim:

- **Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 “ Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis ”**
- **Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit”**
- **Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”**
- **Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”**
- **Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja” i ndryshuar.**
- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”**
- **Vendim Nr. 123, datë 17.02.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”**
- **Vendim Nr. 313, datë 09.05.2012 “Për rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis.**
- **Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”**
- **Vendim Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për zhvillimin e procedures se VNM-se”**
- **Vendim Nr. 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese”**
- **Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”**
- **Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”**

**Aktiviteti i ketij subjektit mbeshtetet ne parimet baze te mbrojtjes se mjedisit:**

- a)Parimin e zhvillimit te qendrueshem duke lejuar zhvillimin e ketij aktiviteti ne perputhje me aktivitetet e tjera te kesaj zone .
- b)Parimin e kujdesit per te pakesuar rrezikun mjedisor, per te parandaluar e minimizuar ne kohen e duhur çdo demtim te mundshem te mjedisit.
- c)Parimin e parandalimit duke miratuar variantin me te mire,qe ne fazen e vendimmarrjes per te shmangur ndikime te demshme te veprimtarise ne mjedis.

- ç).Parimi “ndotesi paguan” qe nenkupton koston qe paguan ndotesi per permiresimin e nje mjedisi te ndotur dhe per kthimin e tij ne gjendje te pranueshme,d.m.th pagesen e takses vendore per pastrimin e ambientit.
- d)Parimi i pergjegjesise ligjore.
- e)Parimi i mbrojtjes ne shkalle te larte.
- f)Parimi i integritit te mbrojtjes se mjedisit ne politikat sektoriale.
- g)Parimi i ndergjegjesimit dhe i pjesmarrjes se publikut ne vendimmarrjen mjedisore.

## **1.2 Metodika e Studimit te VNM-se**

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje proces qe siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme, sinjifikante jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim, zbatim te aktivitetit qe do te zhvillohet.

*Ndikimi* – efekti i zhvillimit te aktivitetit ne mjedis

*Vleresimi* – analiza qe i behet aktivitetit per evidentimin e ndikimeve negative dhe pozitive

*Mjedis* – elementet abiotike ( kushtet fiziko- kimike te mjedisit) te kombinuara me elementet biotike ( qeniet e gjalle te mjedisit).

**Mjedis fizik perbehet nga :**

- qeniet e gjalla ( flora , fauna)
- pjesa jo e gjalle ( toke, ajer, uje )
- peisazhe ( ndikimi vizuale)
- pasurit materiale
- pasuri kulturore ( interes historik, turizem )

**Mjedis shoqeror ndahet ne :**

- personal
- nderpersonal
- institucional ( shendet, ekonomi, etj)

Per te ber nje vleresim sa me te sakte te ndikimeve ne mjedis nga zhvillimi i aktivitetit, studimi i vleresimit te ndikimit ne mjedis u orientua nga rendesia dhe madhesia e projektit, vendi ku ai ndodhet, pasurite natyrore dhe humane te zones si dhe vlerat e veçanta te tyre ne indentifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutese per eliminimin, zvogelimin e ndikimeve duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike te investitorit.

**Studimi strukturohet ne kater faza kryesore :**

- 1.Ngritja e objektiveve orientuese te V.N.M.
- 2.Shqyrtimi i materialeve teknike.



3.Verifikimi ne terren i te dhenave ekzistuese dhe mbledhja e te dhenave te mundshme biofizike dhe humane.

4.Hartimi i raportit te vleresimit te ndikimet ne mjedis sipas legjislacionit mjedisor.

Ky studim ka per qellim te jap konsideratat mjedisore te projektit te propozuar ne menyre qe te orientoje institucionet dhe organet vendim marrese ne dhenien e miratimin e lejes se kryerjes te aktivitetit.

**Per te arritur nje vleresim sa me real te territorit duhet te analizojme situaten duke evidentuar pikat kyce si:**

- Legjislacioni mjedisor
- Madhesia e projektit
- Pozicioni gjeografik ku do te zhvillohet
- Ndikimet e mundshme ne mjedis si pasoje e zhvillimit te aktivitetit
- Te dhenat gjeologjike te zones
- Te dhenat mbi floren dhe faunen e zones
- Historia arkeologjike dhe monumentet e kultures
- Popullsia , gjendja ekzistuese dhe e ndryshimeve

### **1.3 Informacion mbi shoqerine**

Subjekti i cili do te zhvilloj aktivitetin ” **Ndertim godine industriale, kapanon**” eshte **EURO ALB 2009 sh.p.k** i regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 28-09-2009 dhe themeluar me date 24-09-2009 me numer NIPTI **K93328404A** , forma ligjore **SHPK**. Subjekti zhvillon kete aktivitet per ndertim godine industriale, kapanon duke u mbeshtetur ne rendesine e hartimit te studimeve urbanistike rajonale dhe mjedisore me standarte bashkohore, per permbushjen e kerkesave te investitorit per projektin qe do te realizohet.

## **KAPITULLI II**

### **PERSHKRIMI I PROJEKTIT DHE VEPRIMTARISE**

#### **2.1 Qellimi i zhvillimit te projektit**

Qellimi i ketij aktiviteti eshte bazuar ne rendesine e hartimit te studimeve urbanistike rajonale dhe mjedisore me standarte bashkohore, per permbushjen e kerkesave te investitorit per projektin qe do te realizohet, pasurite natyrore dhe humane te zones ne studim, si dhe vlerat e vecanta te tyre.. Te gjitha proceset e punes qe nga sigurimi i lendeve te para e deri ne perfundim do te zbatohen konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrueshem te tij.

## 2.2 Alternativa e analizuar

Perzgjedhja e kesaj zone ka ardhur si rrjedhoje e pronesise se tokes duke e shfrytezuar ate.

## 2.3 Vendodhja e projektit

Prona ne te cilen do te ushtohet aktiviteti “Ndertim godine industrial, kapanon” ndodhet ne fshatin Verbas, Bashkia Patos ne te majte te rruges Fier-Berat, rreth 3-4 km larg ketij aksi.



*Pamje nga Google Earth*

## 2.4 Objektivat e projektit te propozuar

Qellimi kryesor i projektit te propozuar eshte te identifikojme efektet e mundshme ne Mjedis, si dhe marrja e masave te domosdoshme per minimizimin dhe parandalimin e efekteve te krijuara ne mjedis nga zhvillimi i projektit “Ndertim godine, kapanon”. Rehabilitimi I zones perreth aktivitetit, si dhe te lihen detyra dhe projekte per investitorin ne sherbim te komunitetit dhe me gjer.

Objektivat e shoqerise jane:

- 1- Pergatitja e sheshit per ndertim
- 2- Ndertimi i kapanonit (subjekti eshte ne procedure per tu paisur me leje ndertimi)
- 3- Sistemimi i shesheve dhe rrugeve te brendshme ne linje ne funksion te aktivitetit qe do te zhvillohet.

Objektivat e hartimit te VNM- se konsistojne ne evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve ne mjedis dhe masat tekniko-organizative per nje zhvillim te qendrueshem te mjedisit, gjate kryerjes se aktivitetit deri ne perfundim te tij, rehabilitimin e hapesires se shfrytezuar per nje mjedis te qendrueshem ne vitet pas ardhese.

I percaktuar me fjale te thjeshta, VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje situatë normale, ky proces aplikohet perpara se te merren vendimet dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te veprimeve te propozuara;
- Te promovojë zhvillimin miqesor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis.

*Zhvillimi i Qendrueshem* eshte nje koncept kyç qe ka marre nje perhapje dhe pranim nderkombetar gjate dy dekadave te fundit. Agjenda 21, dhe plani global per zhvillimin e qendrueshem, theksojne rendesine e vendimarrjes se integruar te mjedisit dhe te zhvillimit, si dhe promovimin e VNM dhe instrumenteve dhe politikave te tjera per kete qellim.

#### Rendesia e VNM

Reduktimi i ndikimeve ne mjeds arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 10 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje vegël kyç per vendimarrjen ne nje zhvillim te propozuar. Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin. VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimarrje te nje autoriteti kombetar.

#### Qellimet dhe objektivat e VNM

VNM-ja eshte nje proces qe ka si qellim kryesor identifikimin e pasojave ne mjedis, sociale dhe ekonomike te nje projekti para vendimarrjes per zbatimin e tij. Nepermjet VNM realizohet mbrojtja e mjedisit qysh ne fazen e hartimit ose dizenjimit te projektit, gjenden rruge ose menyra per te zvogeluar ndikimet negative, propozohen alternative ose zgjidhje te tjera per vendimmarresit. Qellimi dhe objektivat e VNM mund te ndahen ne dy kategori.

*Qellimi i pare*, drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar si te konsiderueshme e potenciale ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar.

*Qellimi perfundimtar*, afatgjate i VNM eshte te promovojë zhvillimin e qendrueshem duke

siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitetit si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

*Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:*

- Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit; dhe
- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjete termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.

*Objektivat afatgjate te VNM jane:*

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, pesiazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve; dhe
- Permireson aspektet sociale te projektit

VNM-ja eshte ne funksion te mbrojtjes se mjedisit dhe favorizon zhvillimin e qendrueshem, integrin mbrojtjen e mjedisit me marrjen e vendimeve qe ne fazat e hershme te planifikimit te aktiviteteve, mbron mjedisin dhe shmang pasojat sociale, ekonomike, kulturore dhe parashikon masat permiresuese per zbutjen e tyre ne rast te zhvillimit te nje aktiviteti, merr ne konsiderate perfshirjen e publikut, agjensive ose shoqatave ne vendimarrjen per zhvillimin e aktivitetit.

VNM-ja mund te coje ne reduktimin e koston dhe kohes per zbatimin e projektit dhe ne permiresime te ligjeve dhe rregulloreve. Procesi i VNM mund te arrije ne tre perfundime te mundeshme:

1. *Nuk ka efekte negative te projektit ose efektet jane te njohura por ndikimi nuk eshte sinjektiv*
2. *Efektet mjedisore nuk mund te njihen qe ne fazen e hartimit te projektit*
3. *Efektet e pritshme jane te konsiderueshme dhe sinjifikative ndaj duhet bere rishikimi i projektit.*

### **Legjislacioni kryesor shqiptar per mjedisin, evolucioni i tij**

*Ministria e Mjedisit (MM)*

Per here te pare, ne vitin 2001 u krijua ne shqiperi Ministria e Mjedisit. Historiku i institucioneve ne mbrojtje te mjedisit fillon ne vitin 1991, kur brenda Ministrise se

Shendetesise u krijua Komiteti per Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit. Ne vitin 1998, Parlamenti Shqiptar miratoi Ligjin Nr.8364, 02.07.1998 “Per mjedisin”, ligj i cili transformoi Agjencine Kombetare te Mjedisit ne institucion te pavarur i cili ishte ne varesi direkte dhe raportonte tek Kryeministri. Krijimi i Ministrise se Mjedisit ne vitin 2001 vazhdoi perpjekjet dhe tendencen per t’i dhene rendesine e duhur autoriteteve te mbrojtjes se mjedisit. Ne vitin 2005, Ministria e Mjedisit, ndryshoi emertimin ne Ministria e Mjedisit, duke marre keshtu edhe me shume kompetenca ne pasuri te tjera natyrore te vendit si ujrat, pyjet dhe peshkimi. Pozicioni, dhe kompetencat e reja te autoriteteve te mjedisit brenda qeverise, krijojne mundesi per te ndermarre me shume veprime dhe nisma ambicioze per te forcuar kapacitetet administrative dhe per te ngritur institucionet e duhura pergjegjese per menaxhimin e mjedisit.

#### Autoritete te tjera ne nivel qendror qe lidhen me mjedisin

Komisioni Parlamentar per Shendetesine dhe Mjedisin, punon per Parlamentin dhe rishikon draft-ligjet e pregatitura nga MM, aprovon marreveshjet nderkombetare dhe organizon dhe aprovon debatet per ceshtjet e mjedisit. Ka dhe nje numer te caktuar Ministrish dhe institucionesh te tjera shteterore qe kane marre dhe marrin masa te rendesishme per mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit. Disa nga keto ministri kane krijuar departamente dhe njesi perkatese pergjegjese per mjedisin ne sektorin qe te mbulojne.

#### Ne nivel rajonal dhe lokal

Ne nivel rajonal, pergjegjese per mjedisin jane Agjencite Rajonale te Mjedisit (ARM), te cilat jane strukture e MM. Ne vendin tone jane 12 ARM te organizuara ne nivel Prefektore. Ne nivel lokal, njesite e qeverisjes vendore Bashkite, jane pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit, megjithse ne pergjithesi ato nuk kane staf te specializuar per problemet e mjedisit. Bejne perjashtim ketu Bashkite e nivelit te pare Bashkia Tirane, Durres, etj.

### **Legjislacini i VNM-se**

**Ligji pare** per mjedisin eshte ai me Nr.7664, date 21 Janar 1993, i cili e permend VNM por nuk qarteson asnje procedure per kryerjen e saj.

**Ligji dyte** ne serine e legjislacionit mjedisor eshte ai me Nr.8364, date 02.07.1998 “Per mjedisin”, i cili serisht e ka kete difekt per VNM.

Duhet theksuar se vendi yne ka edhe legjislacionin e tij mjedisor te hartuar keto vitet e fundit, sidomos pas vitit 2002 kur edhe ka filluar plotësimi i kuadrit legjislativ ne fushen e mjedisit. Ky kuadër legjislativ permbledh te gjitha llojet e akteve legjislative duke filluar nga Kushtetuta e Republikes se Shqiperise, ligje te përgjithshme per mjedisin dhe per perberes te veçante te tij, vendime te këshillit te ministrave, urdhra dhe udhëzime te ministrive, rregullore specifike, norma e standarde, etj. Ky legjislacion eshte i përfaqesur me standartet e Bashkimit European sepse mbeshtetet ne te njëjtat parime qe eshte mbështetur legjislacioni mjedisor evropian, por gjithashtu eshte hartuar me asistencen e eksperteve te huaj duke respektuar keshtu edhe konventat nderkombetare ku shteti shqiptar eshte pale.

Kuadri aktual ligjor per VNM eshte parashikuar ne:

- Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”
- Ligji Nr. 10 440 datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”

Direktivat kryesore ne te cilat janë mbështetur bazat kryesore ligjore janë:

- Direktiven 85/337/EEC te Keshillit te Europes
- Direktiven 2001/42/EC E te Parlamentit European dhe Keshillit te Europes
- Direktiven 2004/35/CE te Parlamentit European dhe Keshillit te Europes

Megjithate, legjislacioni mjedisor vazhdon te jete ne nje proces intensiv plotësimesh e permiresimesh per t’u pershatatur me standardet dhe normat me te mira mjedisore dhe per te siguruar nje zhvillimi te qendrueshem te ekonomise se vendit.

*Permbledhje te përgjithshme te karakteristikave te VNM-se*

<b>Qellim</b>	<b>VNM</b>
<b>Procesi i vleresimit</b>	Vlerësimi ---> Raporti ---> Miratimi ---> Monitorimi
<b>Shkalla e vleresimit</b>	E krahasueshme me ndikimet potenciale
<b>Mbulon fushat</b>	Mjedisore, Social-ekonomike, të trashëgimisë kulturore, etj
<b>Konsideron</b>	Politikën Mjedisore, Institucionale dhe Monitoruese
<b>Niveli</b>	I detajuar për një projekt
<b>Procedura e raportit</b>	Shtojca 1 – Projektet qe i nënshtrohen Procedures se Thelluar te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis Shtojca 2 – Projektet qe i nënshtrohen Procedures Paraprake te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis
<b>Baza ligjore</b>	Ne përmirësim te vazhduar
<b>Mbeshtetur</b>	Legjislacioni Shqiptar, Direktivat e EU (si Direktiva 87/11/EC) Praktikate internacionale (si udhezuesit e Bankes Boterore OP 4.01).
<b>Adreson</b>	Çështje të projektit specifik

***Klasifikimi i aktivitetit sipas ligjeve baze***

Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM) i veprimtarive ndertuese dhe prodhuese Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”

Ligji Nr. 10 440 datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” përcakton detyrimet per Pajisjen me Leje Mjedisore te subjekteve fizike dhe juridike qe kerkojne te ushtrojne nje veprimtari qe ka ndikime ne mjedis.

Ligji Nr. 10 440 datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”Kreu II, Neni 7, shprehet:

- 1- Procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis i nenshtrohen te gjitha projektet dhe veprimtaritet qe jepen ne shtojcat 1 dhe 2 te ketij ligji, perpara miratimit te tyre nga organet perkatese.
- 2- Projektet dhe veprimtarite i nenshtrohen dy niveleve te shqyrtimit per vleresimin e ketij ndikimi:



- Raport i thelluar i vleresimit te ndikimit ne mjedis
- Raport paraprak i vleresimit te ndikimit ne mjedis

Si dhe mbeshtetur ne Vendimin Nr.805, dt 04.12.2003 “Per miratimin e listes se veprimtarive, qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkohet Leje Mjedisore“.

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton nivelin e shqyrtimit per vleresimin e ndikimit ne mjedis te projekteve apo veprimtarive qe kerkojne operojne ne territorin e Republikes se Shqiperise para implementimit. Dy nivelet e shqyrtimit te VNM-ve jane:

Kerkesat e studimit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

Mbeshtetur nga informacioni ne lidhje me karakteristikat e projektit, vendndodhjen e projektit (te dhena per mjedisin, banoret dhe kulturen) dhe impaktin potenciale te projektit, informacion i cili do te perdoret nga MM dhe do te percaktoje nevojen per nje VNM te Permbledhur apo te thelluar.

## KAPITULLI III

### PERSHKRIMI I VENDIT DHE KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

#### 3.1 karakteristikat e zones

Rrethi i Fierit ofron potenciale te rendesishme natyrore per zhvillimin e tij. Ne pergjithesi kemi te bejme me nje rajon fushor me lartesi 0-100 m mbi nivelin e detit dhe me toka shume pjellore. Ne zonat e rrafsha zhvillohen tokat e hirta kafe. Kemi edhe lloje te vecanta tokash si aluvionale qe takohen ne luginat e Semanit e Vjoses, tokat e kripura qe shtrihen ne Hoxhare si dhe tokat mocalishte te Rroskovecit. Ne rrethin e Fierit shtrihet nje pjese e Myzeqes se Madhe, Myzeqeja e Vogel dhe fushat e Frakulles e te Cakrranit. Fiery ashtu si e gjithe Shqiperia ben pjese ne brezin e klimes mesdhetare, dhe dallohet per tipare te shprehura mesdhetare, e cila karakterizohet nga vera e nxehte dhe e thate me shkelqim te madh te diellit dhe dimri I bute dhe me rreshje te medha.



#### 3.2 Pershkrimi gjeologo-morfologjik i zones

Shqiperia si formacion gjeologjik eshte pjese perberese e rrudhosjeve alpino-mesdhetare pjese e degezimit Dinaro-albano-Helenid, ku ne bejme pjese tek Albanidet. Rrethi Fier ben pjese ne Ultesiren jug Perendimore dhe karakterizohet nga shkembinj te dobet qe i ben te paqendrueshem nga rreshqitja dhe eshte pjese e sistemit neogjenik argjila, konglomerat ranor. Zona karakterizohet nga brezi i tokes se hirta kafe, ku ajo vendoset mbi formacione sedimentare dhe sasia e humusit eshte e vogel rreth 2-4% dhe reaksion lehtesisht acid. Nëntoka është mjaft e

pasur me lëndë djegëse siç janë gazi natyror dhe nafta. Gjithashtu nëntoka është e pasur edhe me materiale ndërtimi si zhavorë, rërëra, argjila etj.

### 3.3 Regjimi Klimaterik

Rrethi i Fierit shtrihet në pjesën jug-perendfanore të territorit të Qarkut Fier, kufizohet në veri nga rrethi i Lushnjes, në lindje nga

rrethi i Beratit, jug-Undje nga Mallakastra dhe në jug nga rrethi i Vlores. Sipërfaqja e rrethit Fier është: 152.65 km<sup>2</sup> ndërsa Popullsia e rrethit Fier është rreth: 263.701 banorë.

Patosi përfaqësohet në zonën klimatike mesdhetare fushore të Shqipërisë. Klima e kësaj zone karakterizohet nga dimër i butë dhe i lagët dhe verë të nxehtë dhe të thatë. Vendmatjet bazë që kanë shërbyer për studimin e veçorive klimatike të zonës janë Fieri dhe Vlora.



### Diellezimi

Një nga elementet baze që karakterizon klimën e një zone është regjimi i diellzimit që shprehet nëpërmjet numrit të ditëve të kthjellta dhe atyre të vranëta. Për ditët e vranëta situata paraqitet në kahe të kundërt dhe konkretisht mesatarisht gjatë vitit vërohet rreth 5-6 ditë të vranëta në kohën e verës dhe 10-12 ditë të tilla në kohën e dimrit. Zona e Patosit ka një rrezatim të përgjithshëm diellor vjetor me vlerë  $R = 1611.84$  kWh / m<sup>2</sup>, me ndryshimin mujor që shkon 70.61 kWh / m<sup>2</sup> në janar, që është gjithashtu muaji me rrezatimin diellor më të ulët, me vlerë deri 214.45 kWh / m<sup>2</sup> në muajin korrik kur janë vërejtur vlerat maksimale të rrezatimit. Kohezgjatja e ditëve me diell lidhet me katër faktore që janë: gjatësia gjeografike, pozicioni gjeografik, vranësira dhe tipi i pajisjeve



matese. Bashkia Patos ka deri 2688 ore me diell ne vit. Vlerat e larta jane verejtur gjate kohes se veres dhe vecanerisht ne korrik dhe gusht. Nga ana tjeter vlerat me te ulta jane verejtur ne dhjetor. Korriku dhe gushti kane vlera me te larta se qershori, muaj i cili ka ditet me te gjata te vitit, por kushtet e motit te gushtit dhe qershorit karakterizohen me stabilitet me te vogel sinoptik, me shume vranesira dhe dite me shi.

### **Temperatura e ajrit**

Një element shume i rëndësishëm në karakterizimin e klimës të një zone të caktuar është dhe regjimi i temperaturave. Parametrat me kryesore qe shprehin regjimin e temperaturave janë temperaturat mesatare dhe ato ekstreme (minimale dhe maksimale). Hapësira Grabian-Fier paraqitet pak a shume homogjene për sa i përket regjimit të temperaturave

### **Reshjet**

Reshjet kanë regjim kohor shumë te çrregullt ato janë përqendruar kryesisht ne gjysmën e ftohte te vitit, sasia mesatare e tyre arrin 980-1000mm/vit. Vera ne zonen Fierit është e thate dhe shpesh nuk bie shi për jave te tera. Muajt me te lagësht janë nëntori dhe janari, kurse muajt me te thate korriku dhe gushti.

### **Era**

Erërat fryjnë ne drejtime të ndryshme por gjatë dimrit mbizotëron era e jugut, e cila sjell edhe reshje te mëdha, ndërsa gjatë verës era fryn nga veriu dhe veriperëndimi. Afërsia me detin bën qe klima te jetë e bute dhe vetëm ne raste tepër te rralla temperaturat te bien nën zero.

### **Trashegimia kulturore**

Nga konstatimi ne zone, territori ne studim nuk ndodhet ne distanca te aferta me zonat e mbrojtura nga Instituti i Monumenteve te Kultures . Ne zonen ku ndodhet objekti nuk ka objekte arkitektonike, arkeologjike, kulturore dhe me interesa historike.

### **Sizmiciteti**

Trualli Shqiptar vendoset gjate kufirit te perplasjes se dy pllakave te medha qe levizin njera kunder tjetres; pllakes Euroaziatike dhe asaj Arabo-afrikane, dhe eshte vater e perqendruar termetesh e cila preket me shpesh nga termete demtues.

Zona e Fierit eshte zone e prekur nga termetet ku nga pikepamja sizmoteknike zona mund te goditet nga termete me magnitudo  $M_{max}=5.5-6.0$  grade Richter me intensitet deri ne 7 balle MKS-64 e cila shkakton çarje ne mur dhe rrezim te copa te suvash por mundesite per te goditur termetet me shume balle jane te vogla rreth 20%.

## **Klima**

Klima e rajonit është mesdhetare fushore qendrore me karakteristikat klimaterike të rajonit të Shqipërisë Perëndimore.

Për zonën në studim, përfshihet në zonën klimatike mesdhetare. Janari është muaji me më shumë ftohtësi. Temperatura mesatare 4-10° C. Gjate vitit vrehet rreth 30 ditë me ngrica, në periudhën dhjetor-shkurt, në lartësi mbi 1000 m. Korriku konsiderohet me më pak nxehtësi.

Temperatura mesatare vjetore arrijnë në 25-26 °C.

Temperatura e ajrit në zonën e Fierit ndryshon nga 8.3 deri në 24.0 ° C. Vlera absolute e saj e vrojtuar ka qënë 38.6 °C ,ndërsa vlera absolute minimale e vrojtuar ka qënë - 0.6 °C

Rreshjet përgjithësisht bien gjatë stinës së vjeshtës e dimërimit dhe vlerësohen në 900 - 1100 mm në vit.

Shpërndarjen e reshjeve sipas muajve, përgjatë vitit të fundit e tregojnë tabelat e mëposhtme:

Në Shqipëri erërat që rastisin me shumë gjatë gjithë vitit janë ato të kuadrantit të veriut dhe pas tyre ato të jugut. Në përqindje të vogël rastisin erërat perëndimore dhe lindore.

Në zonën e Fierit mbizotërojnë erërat me drejtim qendror (39.3%) me pas ato me drejtim juglindor (18.2%), drejtim veri-perëndim (15.2%), dhe pjesa tjetër varion nën 8%. Era në këtë zonë fryn e lehtë gjatë periudhës së verës dhe pak më e fortë në dimër .

Drejtimi i erës është i ndryshëm sipas periudhës kohore por në përgjithësi era fryn në drejtim të veriut dhe veri-perëndimit. Shpejtësia e erës varion nga 1-2m<sup>2</sup>/sek.

Zona e Fierit është një zonë me masë ajrore të pa qendrueshme që shoqërohet me reshje shiu gjatë gjithë periudhës së vitit.

### **Shpejtësia e erës dhe drejtimi i saj:**

Erërat fryjnë në drejtime të ndryshme por gjatë dimërimit mbizotëron era e jugut, e cila sjell edhe reshje të mëdha, ndërsa gjatë verës era fryn nga veriu dhe veri-perëndimi. Afërsia me detin bën që klima të jetë e butë dhe vetëm në raste të rralla temperaturat të bien nën zero. Si pasqyrim i kësaj klimë stacioni meteorologjik për zonën e Fierit, përfaqëson përket drejtimin dhe frekuencën të erës, kemi.

#### **a)Drejtimi**

Drejtimi dominues i erës është era që fryn nga veriu e veri-perëndimi.

#### **b)Shpejtësia**

Shpejtësitë më të larta të erërave janë në dimër me shpejtësi mesatare 4.9 m/s, vjeshta 4.3 m/s dhe vera 3.9 m/s. Shpejtësia mesatare e erërave rezulton 4.4 m/s.

## Flora dhe fauna

Në përgjithësi kemi te bëjmë me një rajon fushor me lartësi nga 0-100 m mbi nivelin e detit dhe me toka shumë pjellore. Edhe relievet kodrinore janë përgjithësisht të buta dhe të mundshme për shfrytëzim bujqësor. Ne zonat e rrafshëta zhvillohen tokat e hirta kafe. Kemi edhe lloje të veçanta tokash si aluvionale që takohen në luginat e Semanit e Vjosës, tokat e kripura që shtrihen në Hoxhare si dhe tokat moçalishte të Roskovecit.

Bota natyrore bimore dhe shtazore e rrethit është transformuar nga veprimtaria e njeriut. Megjithatë rrethi i Fierit dallohet për disa lloje bimësh e kafshësh sidomos në pjesët bregdetare e fushore. Takohen disa lloje kafshësh si urithi, çakalli, nusja e lalës, dhelpra, shkurtëza, mëllenja, thëllëza e fushës si dhe disa lloje të ndryshëm zvarranikësh e gjarprinjsh. Ndërsa në ujërat e detit gjenden shumë lloje peshqish si qefulli, levreku, koca etj. Rrethi i Fierit bën pjesë në brezin e shkurreve dhe të pyjeve mesdhetare. Shkurret përbëhen nga nënkati i makies, ku rriten shkurret me gjelbërim të përhershëm si mareja, shqopa, gjjeshtra, dafina. Në këtë nënkat bimor rriten edhe disa drurë të lartë si selvia, valanidhi, pisha e butë dhe e egër, që në disa raste formojnë pyje të vegjël.

### 3. 4 Flora

Zona në fjale bën pjesë në brezin e shkurreve dhe drurë mesdhetare ku përmendim pyjet gjethegjere. Në zonat përreth vazhdojnë të mbijetojnë në pakice si: makiet, shibljaku (driza (*paliurus spina-christi*), cermedelli (*cotunus coggygia*), shqemia (*rhuscoriaria*), shege (*punica granatun*), gorrica (*pyrus amygdaliformis*), murrizet, thana, etj. Në këtë zonë janë mbjelle bime zbukurose (*Pinus nigra*, *pinus conica*, *pinus baccata*, *juniperus virginiana*, etj.), një pjesë e mirë e tyre nga kontributet individuale nga biznesivendas. Një vend të rëndësishëm në tipin e vegjetacionit që ndeshet këtu zënë pyjet higrofile, të cilët i përkasin klasave *Alno-Populeta* dhe *Salicetea purpurea*. Në këto lloj pyjesh në përgjithësi nuk formohet humus dhe toka është lymore, kështu që kushtet edafike janë krejtësisht të ndryshme nga ato të formacioneve të tjera bimore. Përbërësit kryesorë të vegjetacionit të identifikuar këtu janë: *Populus alba*, *Salix purpurea*, *Salix amplexicaulis*, *salix elaeagnos*, *Alnus glutinosa*, *Alnus incana*, *platanus orientalis* etj. këto elemente takohen gjatë segmenteve rrugore, buzë lumienjve dhe kanë një histori të caktuar zhvillimi të lidhur me vetë evolucionin e rjedhjeve lumore. Substrati në të shumtën e rasteve ka karakter zallishte dhe në këto mjedise rriten shoqërime me *Platanus orientalis* i shoqëruar me shkurre higrofile si *Salix elaeagnos*, *Tamarix parviflora* etj., ndërkohë që disa ujëra me rjedhje të qetë substrati është lymor e këtu rriten shoqërime me *Alnus glutinosa*, *Salix alba*, *Alnus incana* etj. Në disa mjedise të veçanta takohet shoqërimi i plepit të bardhë që dallohet nga fizionomia ekologjike dhe nga ana floristik. Në përgjithësi ky tip është i diferencuar në tri kate: Në katin drunor, ku përveç plepit të bardhë takohen edhe shelgu i bardhë (*Salix alba*), plepi i zi (*Populus nigra*), vidhi i shoqët (*Ulmus glabra*), vidhi më i vogël (*Ulmus minor*) dhe më rrallë frashëri gjethengushtë (*Fraxinus angustifolia*). kati shkuror paraqitet më i rrallë, ndërsa flora barishtore është e varfër në lloje si: *Equisetum telmateia*, *Equisetum ramosissimum*, *Prunella vulgaris* etj. Po kështu këtu takohen dhe liana si *Tamus communis*, *Humulus lupulus* etj.

### 3.5 Fauna

Aspekti faunistik i lidhur ngushtë me mjedisin rrethues këtu, parqet një larmi biologjike tepër të varfër, që është po kështu një pasqyrim i gjendjes së këtij ekosistemi tashmë tepër të degraduar. Vlerat e tanishme faunistike të zonës janë elementare. Takohen shumë pak përfaqësues të shpendëve dhe reptilëve të takuar përgjatë kohës së eksplorimit të zonës. Fauna, e këtushme shënon lloje tipike të një rajoni që ofrom mundësi të kufizuara për ushqim dhe vendstrehim. Ndërtimi i venddepozitimit, mund të përbëjë një atraksion pra tërheqje për lloje të tjera duke shfaqur dhe një ndryshim në elementet e faunës aktuale. Bazuar në vëzhgimet e terrenit nuk është e vështirë që të nxiret si perfundim se fauna e këtushme është tepër e varfër. Fauna e kësaj zone është tipike mesdhetare.

Normalisht nëse zona do të kishte një bimësi shkurore që është tipike për një vend mesdhetar si ky, atëherë larmia e shpendëve do të ishte tërheqëse. Këtu takohen edhe pse në raste sporadike lloje si *Picus canus*, *Picus viridis*, harabelë, *Passer domesticus*, *Pica pica*, *Corvus corax*, çafka, *Hirundo carduelis*, pëllumbi i ujit *Larus ridibundus*.

Në sistemin e kanaleve ujore , si dhe ne rezervuaret pereth takohen kryesisht lloje Amfibesh, te dominuar nga gj. Rana dhe Bufo. Nga përfaqësuesit e amfibëve ndeshen llojet *Bufo viridis*, *Buffo buffo*, *Rana sp. etj.* ndërkohë që në rjedhjet e mësipërme ndeshet *Triturus vulgaris*. Llojet kryesore të peshqëve të evidentuar këtu janë: *Alburnoides bipunctatus* dhe llojet e introductuar si *Caracsius gibelio*, *Ctenopharyngodon idella, etj.* Gjitarët jane te perfaqësuar kryesisht nga *Lutra lutra*. Gjitarët karnivorë që përfaqësohen gjithashtu nga nusja e lalës- *Mustela nivalis*. Lloje të cilët mund të afrohen më shumë me vendin e projektit janë minjë e llojeve *Rattus rattus*, *Rattus norvegicus*. Zona ne studim e Bashkis Patos nuk dallohet per ndonje bote te pasur shtazore. Si zone ne studim qe ben pjese ne Qarkun e Fierit karakteristike jane kumriet. Per zonen ne studim nuk zoterohet ndonje material i hollesishem. Prania e kafsheve te egra ne kete zone mungon totalisht, per me teper aty nuk ka as kafshe shtepiake pasi zona eshte e mbushur me ndertime. Zogjte qe karakterizojne zonat perreth jane si: pellumbi (*Streptopelia decaoto*), trumcaku (*Troglodytes*), harabela (*passer domesticus*), kumriet, etj. Ndersa insekte kemi brumbuj, grereza, milingona, pilivesa, mushkonja, flutura etj. Nuk vihen re prania e ndonje specie qe eshte e perfshire ne “Librin e Kuq”.

### 3.6 Hidrogjeologjia

Ne kete rajon takohen ujerat nentokesore ne depozitat zhavorr dhe ne nje thellesi 2.7 m deri ne 5.5 m por ne puset e shpimit ai arrin te ngrihet dhe te stabilizohet ne 0.6-0.8 m thellesi dhe ne varesi te stines niveli i tyre ndryshon.

Ne siperfaqen e truallit ku do te zhvillohet aktiviteti nuk ka burime siperfaqesore dhe perreth saj nuk ka zona ujore , nuk ndodhen lumenj e liqene. Jane marre masat ,ne baze te kondicioneve teknike qe gjate aktivitetit nuk do te kete problem ne hyrjet e daljet e automjeteve ne kete subjekt.

## KAPITULLI IV

### PERSHKRIMI TEKNIK PROJEKTIT

#### 4.1 Karakteristikat kryesore

Projektit “Ndertim godine, kapanon” konsiston ne ndertimin e ketij kapanoni ne fshatin Verbas, Bashkia Patos, Qarku Fier ne te majte te rruges Fier-Berat, rreth 3-4 km larg ketij aksi. Siperfaqja ne te cilen do te nderhyet eshte rreth 6900 m<sup>2</sup>.

Projekti “Ndertim godine, kapanon” parashikon nderhyrje permiresuese ne lidhje me problematikat e hasura, shtimin e funksioneve aktuale , ruajtjen dhe permiresimin e pejsazhit. Projektimi ka mbajtur ne konsiderate dhe aktivitetet e ndryshme social-kulturore.

#### **Me poshte pasqyrohen siperfaqet perkatese dhe pershkruhen me shifra elementet e projektuar te ketij kapanoni:**

Siperfaqja qe zhvillohet 6900 m<sup>2</sup>

Siperfaqja e pergjithshme e ndertimit mbi toke 1200 m<sup>2</sup>

Intesiteti i ndertimit 0.17

Koeficienti i shfrytezimit te truallit 0.17 %

Lloj i mbuleses - me sanduic metalik

Ne zonen ku do te zhvillohet ky projekt nuk ka shtepi banimi,shkolla,dhe aktivitete te tjera social kulturore, qe mund te demtohen nga zhvillimi i ketij projekti nga subjekti. Objekti do te ndertohet ne nje siperfaqe te sheshte,ne kuoten e rruges. Ky studim percakton nje menyre zhvillimi te kesaj zone duke percaktuar disa kriteret parimore mbi zonen ,menyren e ndertimit , koeficientin e shfrytezimit te truallit, ushtrimin e projektit etj. Subjekti ka per qellim ushtrimin e projektit “Ndertim godine, kapanon” E rendesishme eshte te theksojme se rrethimi i ambjentit,ku do te ndertohet kapanoni industrial nga ky subjekt ka sjelle nje impakt estetik pozitiv ne krahasim me gjendjen e meparshme, duke kontribuar e ndikuar ne zhvillim racional dhe pozitiv te kesaj zone. Investitori privat ka kryer te gjitha studimet perkatese dhe ka bere studimin e infrastruktures inxhinjerike,si dhe studimin e qendrueshmerise se tokes, para se te filloje nga puna,ndertimi i. “Ndertim godine, kapanon”.



*Foto nga toka ku do te ndertohet kapanoni*

#### **4.2 Lenda djegese**

Procesi nuk perdor lende djegese, vetem perdorin mjetet e ngarkim- shkarkimit sipas normativave e kohes se punes.

#### **4.3 Programi i punes**

Per zhvillimin e projektit eshte kaluar ne disa faza

- Fillimisht eshte vendosur zona ne te cilet do behet nderhyrja pra ndertimi i kapanonit e cila eshte toke are ne pronesi te subjektit EURO ALB 2009
- Piketimi i nderteses (ne kuota absolute) .



#### **4.4 Furnizimi me uje**

Furnizimi me uje do te realizohet me pus te cilin subjekti do ta hapi ne ambjentet e aktivitetit.

#### **4.5 Furnizimi me energji**

Edhe energjia qe do te perdoret do te jete energji elektrike e cila do te sigurohet nga rrjeti energjistik i qytetit.

#### **4.6 Faza e funksionimit**

Procesi i punes fillon me piketimin e zones ku do te ndertohet pastaj vazhdon me ndertimin e kapanonit industrial.

#### **4.7 Mbetjet dhe emetimet ne mjedis**

Me poshte jepet nje pershkrim i detajuar i mbetjeve dhe shkarkimeve te tyre ne mjedis, sipas etapave te procesit, natyres, sasive te tyre dhe drejtimet ne te cilat ato shkarkohen se bashku me efektet e mundshme te demshme qe mund te krijohen per tani dhe per nje te ardhme te larget.

##### **Mbetjet e ngurta**

- Vijne nga aktiviteti human, mbetje urbane te plastikes, qelqit, metaleve etj. Te cilat jane te riciklueshme dhe do te hidhen ne kontenieret e mbetjeve urbane te zones. Nga aktiviteti i kapanonit nuk vleresohet te kete mbetje te ngurta ose jane ne sasi shume te vogel qe mjaft mire mund te klasifikohen sit e gjitha mbetjet e tjera te aktivitetit human.

##### **Mbetje te lengeta**

- Nuk ka .

#### **4.8 Zhurmat**

Zhurmat ne kete objekt do te shkaktohen vetem nga makinat e ngarkim shkarkimit (kamion normal per transportin e agregateve). Nivelet e zhurmave te lidhura me aktivitetin e trafikut jane si me poshte:

40 dBA zona te qeta rezidenciale

70 dBA rruge me trafik te lire

85 dBA trafik i rende

## Vibracionet

Nuk paraqesin problem per popullsin qe ndodhet perreth, as per punonjesit qe punojne aty. Pajisjet jane te ekuilibruara ne menyre te kenaqeshme. Kjo fal konstruksionit dhe nivelit teknik te pergatitjes se tyre.

## KAPITULLI V

### VLERESIMI I NDIKIMEVE

*Metoda e zbatuar per parashikimin e ndikimeve ne mjedis*

Per vleresimin e ndikimeve ne mjedis te projektit u ndoqen hapat e me poshteme:

- Njohja me projektin dhe teknologjine e tij.
- Njohja me natyren e operacioneve te nevojshme ne mjedis.
- Njohja me vleren natyrore dhe mjedisore te zones dhe siperfaqes ku do te zhvillohet aktiviteti
- Njohja me infrastrukturen egzistuese dhe nevojen per infrastrukture te re per projektin.
- Njohja me lendet e para qe do te perdoren per zhvillimin e aktivitetit.

**Indetifikimi i ndikimeve** – Permes te cilit u percaktua nderveprimi mjedis-projekt i rehabilitimit te lagunes dhe mbrojtjes se kanalit te shkembimit te ujit Lagune-Det-Laguna Vainit dhe u indetifikuan ndikimet e mundeshme gjate fazes qe do te zhvillohet aktiviteti sipas receptoreve te mjedisit.

**Vleresimi i ndikimeve** – Ekspertet mjedisore te fushave te ndryshme ben perpjekje per matjen e gravitetit te ndikimeve . Vleresimi i Sinjifikances ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe eshte faza me e rendesishme per zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe parafron ate me objektivisht me teresine e bashkeveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e perdorur per vleresimin e rendesise se ndikimeve variojne dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit te ndikuar.

*- shtrirja fizike dhe kohezgjatja e ndikimeve te identifikuar ( Shkalla)*

**Shtrirja fizike-** Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinor te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim, p.sh. ndikimi ne toke nga makinerite eshte nje ndikim saktesisht i percaktuar i cili mund te matet , por ne se do te kete erozion te tokes ndikimi rritet ne permasa fizike te siperfaqes.

**- Kohezgjatja e ndikimit** – Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkoshem).



**-Kthyesmeria** –Vlereson mundesin e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te me pareshme (aftesia per tu rehabilituar dhe regjeneruar ).

**-Rendesia** – Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

